

DEKLARATË PUBLIKE

DATË 18.05.2026

DREJTUAR:

- Presidenca e Republikës së Shqipërisë
- Kryeministria e Republikës së Shqipërisë
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
- Kontrollit të Lartë të Shtetit
- Bashkia Durrës
- Këshilli Bashkiak Durrës
- Prefektura e Qarkut Durrës
- Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
- Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
- Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

PËR DIJENI:

- Znj. Ina Zhupa, në cilësinë e Kryetares së Komisionit Parlamentar për Kulturën dhe Diasporën pranë Kuvendit të Shqipërisë
- Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), Shqipëri

LËNDA: Evidentime dhe kërkesë për transparencë mbi çështjet e ngritura në Forumin Publik për projektin TID Durrës dhe ndikimin në trashëgiminë kulturore

Të nderuar,

*Në vijim të Forumit Publik të zhvilluar në Durrës, më datë 28 shkurt 2026, ku morën pjesë 50 persona (vërtetuar me listë-prezencën e nënshkruar prej tyre), mbi çështjen e Projektit "TID Durrës" dhe ndikimin e tij në transparencën institucionale dhe trashëgiminë kulturore të qytetit, si edhe pas intervistave, e mbledhjes së opinionit të banorëve, ekspertëve dhe qytetarëve në tërësi në muajt mars-prill 2026, po ju përcjellim këtë **Deklaratë Publike**, me qëllim reflektimin institucional dhe ndërmarrjen e masave konkrete.*

Qendra Amfora është angazhuar që prej vitit 2017 në mbrojtjen, promovimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore të qytetit të Durrësit. Nëpërmjet aktiviteteve informuese, forumeve publike, medias dhe advokimit qytetar, Qendra Amfora, si një organizatë jofitimprurëse, synon të forcojë transparencën institucionale, pjesëmarrjen publike dhe mbrojtjen e interesit qytetar në proceset që lidhen me zhvillimin urban dhe trashëgiminë kulturore. Veprimtaria e saj mbështetet në promovimin e vlerave demokratike, lirisë së informimit, dialogut publik dhe ruajtjes së memories historike dhe identitetit kulturor të qytetit.

1. Qëllimi i dokumentit

Ky dokument ka për qëllim të përcjellë pranë institucioneve përgjegjëse në nivel vendor dhe qendror gjetjet kryesore, evidentimin e problematikave dhe rekomandimet e dala nga forumi publik informues dhe konsultues mbi projektin “*Tourism Improvement District - TID Durrës*”. Forumi u organizua me synimin për t’i dhënë zë shqetësimeve të ngritura nga komuniteti dhe ekspertët, si edhe për të hapur një diskutim publik mbi këto çështje, me qëllim kërkimin e zgjidhjeve të mundshme në vijim. Në këtë kuadër, dokumenti synon gjithashtu rritjen e transparencës institucionale, respektimin e kuadrit ligjor dhe minimizimin e ndikimeve të pakthyeshme në zonën historike të Durrësit.

2. Kuadri i aktivitetit dhe qasja

Forumit u konceptua si një hapësirë dialogu publik, pa karakter promovues apo protestues, ku u dëgjuan perspektiva të ndryshme dhe u evidentuan problematika që lidhen me projektin, si edhe u diskutuan alternativa dhe zgjidhje të mundshme (*me materialin audio-viziv mund të njiheni edhe përmes kanalit në "Youtube": Media Amfora dhe video me titull: "Forumit publik për TID Durrës: Alarm për transparencën dhe trashëgiminë"*, si edhe përmes linkut:

<https://www.youtube.com/watch?v=9M8Dw4Yb3R8>)

Objektivat e aktivitetit përfshinë informimin mbi ecurinë e projektit, evidentimin dhe artikullimin e shqetësimeve të banorëve dhe ekspertëve të fushës së urbanistikës dhe të trashëgimisë kulturore, nxitjen e dialogut ndërmjet palëve të interesuara, si edhe forcimin e pjesëmarrjes qytetare në proceset e vendimmarrjes publike.

3. Konteksti i përgjithshëm i zhvendosjeve

Lagja e Kalasë mesjetare të qytetit në statistikat e viteve 1920 numëronte 5000 banorë brenda rrethimit. Tërmeti i vitit 1926 bëri që Qeveria e asaj kohe të planifikonte rrafshimin e lagjes së Kalasë. Kjo solli një debat shumë të ashpër në muajin tetor të vitit 1927, për ndërhyrjen e cila po ndodhte me mjete plasëse kundër vullnetit të banorëve. Zhvendosjet e detyruara dhe masive të asaj kohë u ndalën me krijimin e Bulevardit Epidamn dhe me ndërtesat e reja të stilit italian të kohës. Me zbulimin e Amfiteatrit, në brendësi të rrethimit, u bënë edhe shpronësimet e para, duke rivendosur banorët po në të njëjtën lagje - përmes ndërtimit të pallateve 5 katëshe të socializmit. Ndërtimi tyre fshiu përgjithnjë mundësinë e vijimit të dosjes për lagjen e Kalasë në UNESCO. Tërmeti i viti 2019, rihapi mundësinë për të hartuar një plan rindërtimi për Lagjen e Kalasë, përqendruar tek unaza urbane përfaqë amfiteatrit. Ashtu si pas tërmetit të vitit 1926 edhe këtë herë po synohet boshatisja e lagjes së Kalasë, duke shembur mbi 90% të sipërfaqeve ndërtimore, të banimit në të. Projekti u emërtua Zona 5 e Rindërtimit, nëpërmjet një vendimi të kryetares Bashkisë Durrës, duke përdorur dokumente të reja në Ligjin e Planifikimit Urban, si Plani i Detyruar Vendor, (shih Vendimin Nr. 39, dt.19.5.2021, Bashkia Durrës). Mbi këtë zonë të që synohet të boshatiset nga banorët historik, planifikohet ndërtimi i ri nga themelet i disa njësive shërbimesh me disa kate dhe me volum edhe mbi shkallët e amfiteatrit, si një strukturë metalike e ngjashme me atë të Velierës. Për të vazhduar me mision dhe duke zgjeruar fushëveprimin e shembjeve në të gjithë Lagjen e Kalasë, në vitin 2021 u hartua edhe një dokument tjetër, i paqartë për Ligjin e Planifikimit Urban, Plani i Menaxhimit për Zonën Arkeologjike A të Durrësit, emëruar projekti TID. Ky i fundit përvetësoi edhe Planin e Detyruar Vendor, duke e konsideruar si një vendim i njëtrajtshëm për shembjet dhe zhvendosjet masive në lagje. Projekti TID Durrës, i cili synon “rigjallërimin e qendrës historike”, është shoqëruar njëkohësisht me diskutime dhe kundërshti të konsiderueshme publike, veçanërisht në lidhje me të drejtat e pronësisë dhe procedurat e shpronësimit. Për më tepër, janë ngritur shqetësime serioze mbi parregullsi përgjatë gjithë procesit, duke filluar nga planifikimi territorial dhe zhvillimi i projektit, deri te konsultimi publik, transparenca dhe procedurat vendimmarrëse. Këto problematika kanë ngritur shqetësime për pasoja të mundshme negative dhe për humbjen e vlerave të trashëgimisë kulturore.

Në këtë kontekst, përfshirja reale dhe e vazhdueshme e komunitetit, grupeve të interesit dhe ekspertëve, mbetet thelbësore për të garantuar transparencë, llogaridhënie dhe respektimin e të drejtave qytetare, si edhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

4. Gjetje dhe shqetësime kryesore të ngritura në forumin publik të datës 28.02.2026

4.1. Rrezik ndaj integritetit arkeologjik dhe trashëgimisë urbane

- Cenohet narrativa historike e Lagjes Kala dhe me të edhe historia e Durrësit, si një vendbanim në paqe dhe prosperim ekonomik në shekuj, ashtu si Berati me Mangalemin, apo Gjirokastra me Pazarin.
- Amfiteatri i Durrësit është pjesë e Listës Paraprake ("Tentative List") të UNESCO-s dhe është vetëm pjesërisht i gërmuar. Zona përreth përmban një shtresëzim historik: romak–mesjetar–modern.
- Ndërhyrjet para përfundimit të studimeve të plota shkencore rrezikojnë humbje të pakthyeshme të të dhënave arkeologjike.
- Integriteti i sitit lidhet jo vetëm me monumentin, por edhe me veshjen urbane përreth dhe me marrëdhënien historike të tij me qytetin.
- Gjithashtu, është evidentuar mungesa e një strategjie të qartë konservimi dhe e instrumenteve të pavarura të vlerësimit, si edhe mungesa e studimit të VNM-së (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis), ose *ESIA – "Environmental and Social Impact Assessment"*, i cili shoqëron projekte të tilla zhvillimore dhe ndërhyrje në territor.

4.2. Modeli i zhvillimit dhe konflikti me parimet e konservimit

Projekti parashikon të zbatohet nëpërmjet modelit "Tourism Improvement District - TID Durrës", i orientuar drejt intensifikimit ekonomik, "brandimit" urban dhe menaxhimit të hapësirës publike përmes strukturave ndërmjetëse.

- Sipas diskutimeve në forum, ky model mund të krijojë një hallkë të tepërt ndërmjetëse në administrimin e hapësirës urbane, duke cenuar autoritetin vendor dhe duke krijuar përfitime të pabarabarta në raport me bizneset dhe banorët lokalë, si edhe duke rritur kostot dhe rrezikuar autonominë lokale.
- Gjithashtu, është ngritur shqetësimi se ky model mund të hyjë në konflikt me parimet e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe me menaxhimin publik të siteve arkeologjike.

- Ekziston rreziku që lagjja historike të zëvendësohet gradualisht me një produkt urban të komercializuar.
- Ekziston rreziku që narrativa historike të zhvendoset tërësisht si vendbanim romak, e jo i banorëve që e jetuan.
- Trashëgimia kulturore përfshin jo vetëm strukturat fizike, por edhe komunitetin që e ka formuar dhe e jeton atë hapësirë.

4.3. Mospërputhje planifikuese dhe ligjore

Në forum janë ngritur shqetësime mbi përputhshmërinë e projektit me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV 2022), i cili përbën dokumentin detyrues për zhvillimin e territorit.

Janë përmendur gjithashtu dyshime për shkelje të procedurave planifikuese, përfshirë hapjen e nismës për hartimin e PDV-së për projektin TID dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor përkatës, përfshirë edhe vendimet e Këshillit të Ministrave, që lidhen me procedurat e shpronësimit.

- Plani i Detyruar Vendor nuk është dokumenti i Planifikimit Urban dhe është jashtë kornizës Ligjore mbi Planifikimin e Territorit 2014, i përditësuar;
- Plani i Detyruar Vendor është miratuar përpara miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor;
- Ekzistojnë gjithashtu paqartësi në klasifikimin dhe emërtimin e njësive strukturore në zonën e Amfiteatrit midis Planit PPV të firmosur dhe hartës së publikuar nga AKPT (DR_UB_M1_480/173 apo DR_UB_A2_480/19 ?) - Kjo ngatërrese më pas vijon në të gjitha dokumentacionet;
- PPV, Plani i Përgjithshëm Vendor, parashikon llojet e ndërhyrjes, si “Konsolidim” jo “Rijetëzim”, si TID. Referojuni Ligjit mbi Planifikimin Urban, Konsolidimi ka të bëjë me uniformin e arkitekturës, ndërsa rijetëzimi ka të bëjë më ndryshime nga themelet dhe orientimin e rrugëve (bëhet zakonisht për zonat ish-industriale jo trashëgimi);
- PPV, Plani Përgjithshëm Vendor dhe Harta e Përdorimit të Tokës, (Land Use), e firmosur, parashikon që në zonën e Lagjes Kala do të ketë urbanizim, e jo parqe. Zona 5 e Rindërtimit dhe TID bie ndesh. Rritet rreziku për leje të tjera ndërtimore;
- PdyV, Plani i Detyruar Vendor dhe Projekti TID parashikon shembjen nga vlerësime pa vizita në terren të ndërtimeve, gjendjes inxhinierike apo arkeologjike;
- Nuk ka asnjë dokumentacion publik mbi studimet inxhinierike, arkeologjike dhe mjedisore të vendimit mbi shembjet;

- Projekti TID dhe Zona 5 e Rindërtimit nuk ka asnjë buxhet për monitorimin arkeologjik të shembjeve;
- Po ashtu projekti TID dhe Zona 5 Rindërtimit nuk ka asnjë buxhet për projektin, por vetëm vendim shembjesh;
- PdyV, Plani i Detyruar Vendor, bie ndesh me PPV, cila specifikon se në këto njësi strukturore të përfshira në transformimin urban nuk duhet të ketë shembje më shumë se 60% të sipërfaqes totale të ndërtuar;
- PdyV, Plani i Detyruar Vendor sipas Ligjit mbi Planifikimin e Territorit, Neni 22, i përdituar në vitin 2025, mund të anulohet nga 1/3 e banorëve mbartës të kësaj sipërfaqeje në transformim. Bashkia Durrës nuk ka Protokolluar kundërshtimet, që e ka për detyrë ligjore;
- PdyV, Plani i Detyruar Vendor, parashikon ndërtimin e një strukture hekuri mbi shkallët e amfiteatrit, ngjashëm me Velierën, duke rënë ndesh me Ligjin mbi Zonën Arkeologjike A, Neni 3, pika dh);
- Po ashtu, kompetencat për shpronësimet dhe vendimet për prishje objektsh kërkojnë sqarim institucional.

4.4. Mungesë transparence dhe dokumentacioni teknik

Në Planin e Menaxhimit paraqiten parime dhe detaje për ndërhyrjen në zonën historike, por zbërthimi i tyre në dokumentet e planifikimit urban dhe në procedurat konkrete të zbatimit të projektit nuk rezulton i përmbushur.

Gjithashtu, nuk është bërë publik buxheti i plotë i projektit dhe metodologjia e ndërhyrjes në territor. Nuk është parashikuar një fond specifik për studimin metodologjik arkeologjik të zonës. Dokumentacioni teknik nuk rezulton plotësisht i aksesueshëm për publikun.

4.5. Ndikimi social dhe e drejta e pronës

Në forum janë ngritur shqetësime për presion të mundshëm mbi pronarët dhe për mungesë transparence në procesin e shpronësimit. Banorët raportojnë pasiguri mbi të ardhmen e pronës dhe të aktivitetit të tyre ekonomik. Ekziston rreziku i zhvendosjes së komunitetit historik dhe i fragmentimit të vijimësisë urbane dhe sociale të lagjes.

4.6. Qëndrimi i Shoqatës “Durrësi Autokton”

Gjatë forumit publik u deklarua se Shoqata “Durrësi Autokton” ka marrë pjesë në prezantime dhe takime informuese lidhur me projektin TID Durrës, por nuk ka dhënë miratimin apo dakordësinë formale për projektin.

U theksua se çdo referim publik që e paraqet këtë shoqatë si palë mbështetëse për projektin, është sqaruar institucionalisht përmes shkresave zyrtare drejtuar institucioneve përkatëse, ku konfirmohet ky qëndrim, se ata nuk kanë mbajtur qëndrim mbështetës për këtë projekt.

5. Qëndrimi i Qendrës Amfora

Qendra Amfora mban qëndrimin se:

- Proceset e zhvillimit urban dhe turistik në zonat historike duhet të mbështeten në transparencë institucionale, planifikim të dokumentuar dhe akses publik mbi dokumentacionin dhe vendimmarrjen.
- Çdo ndërhyrje që prek trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë duhet të bazohet në ekspertizë të specializuar dhe të pavarur, si edhe në vlerësimin e plotë të ndikimeve historike, sociale, urbane dhe mjedisore.
- E drejta e qytetarëve për informim dhe konsultim publik mbetet thelbësore në proceset që ndikojnë komunitetin, pronën dhe identitetin historik të qytetit.
- Trashëgimia kulturore përfaqëson jo vetëm monumentet dhe asetet fizike, por edhe memorien kolektive, jetën komunitare dhe lidhjen historike të qytetarëve me hapësirën urbane.
- Respektimi i procedurave ligjore, qartësia institucionale mbi kompetencat dhe garantimi i standardeve të llogaridhënies publike janë elemente të rëndësishme për besimin publik dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit.
- Dialogu i hapur ndërmjet institucioneve, ekspertëve, komunitetit lokal dhe aktorëve të interesit publik mbetet i rëndësishëm për trajtimin e përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës të çështjeve që lidhen me zonën historike të Durrësit.
- Roli i medias në informimin e publikut, garantimin e aksesit në informacion dhe nxitjen e debatit të hapur qytetar mbetet i rëndësishëm për transparencën, llogaridhënien publike dhe përfshirjen e komunitetit në çështjet që lidhen me zhvillimin dhe trashëgiminë kulturore të qytetit.

6. Rekomandime për autoritetet përgjegjëse për zbatimin e projektit:

6.1. Transparencë e menjëhershme mbi dokumentacionin

Të bëhen publike, në mënyrë të plotë dhe të aksesueshme:

- Masterplani / Plani i Integruar dhe të gjitha dokumentet përkatëse të planifikimit që shoqërojnë projektin, deri tek pasaportat e objekteve;
- Hartat e detajuara të ndërhyrjeve, duke përfshirë trojet dhe listën e objekteve të prekura;
- Arsytimi i detajuar teknik për çdo rast ndërhyrje ose prishje;
- Metodologjia e ndërhyrjes dhe buxheti i detajuar i projektit, përfshirë kostot për restaurim, ndërhyrje në infrastrukturë, prishje dhe shpronësime, veçanërisht duke marrë në konsideratë vlerën e pritshme që mund të rezultojë nga proceset gjyqësore individuale të banorëve, e cila mund të rrisi ndjeshëm kostot që do të mbulohen nga buxheti i shtetit;
- Dokumentacioni dhe mekanizmat e mbikëqyrjes së ndërhyrjeve arkeologjike.

6.2. Audit i pavarur ligjor dhe procedural

Të realizohet një verifikim i pavarur mbi:

- Respektimin në të gjitha fazat të procedurave të konsultimit publik dhe dokumentimin e tyre;
- Përputhshmërinë me Ligjin për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit dhe me legjislacionin për trashëgiminë kulturore, specifikisht Ligji nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
- Respektimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit mjedisor (VNM);
- Bazën normative të kompetencave për shpronësime dhe vendimet për prishje.
- Rezultatet e auditit të bëhen publike.

6.3. Mekanizëm teknik i përhershëm

Të krijohet një grup pune ndërinstytucional me përfshirjen e:

- Ministrive përkatëse;
- Bashkisë;
- Institucioneve të trashëgimisë kulturore;
- Arkeologëve, restauratorëve dhe urbanistëve të pavarur;
- Përfaqësuesve të komunitetit.

Detyrë e këtij mekanizmi të jetë:

- Vlerësimi i plotë i aseteve të trashëgimisë kulturore në zonë;

- Shqyrtimi i alternativave që minimizojnë prishjet;
- Hartimi i një plani restaurimi të fazuar dhe të qëndrueshëm.

6.4. Parimi i minimizimit të prishjeve dhe mbrojtjes së shtresëzimeve historike

- Çdo vendim për prishje ose transformim në zonën historike duhet të bazohet në parimin e ndërhyrjes minimale dhe të shoqërohet me:
 - Arsyetim teknik të detajuar dhe të dokumentuar;
 - Analizë të alternativave (restaurim, adaptim funksioni, ndërhyrje minimale) përpara çdo vendimi për prishje;
 - Vlerësim të ndikimit në kontekstin historik, urban dhe arkeologjik të zonës;
 - Mbikëqyrje arkeologjike të vazhdueshme gjatë çdo faze të ndërhyrjes dhe dokumentim të plotë të çdo gjetjeje arkeologjike;
 - Respektim të parimeve të konservimit dhe të praktikave ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

6.5. Pezullim i ndërhyrjeve të pakthyeshme

Deri në përfundimin e procesit të transparencës dokumentare dhe realizimin e auditit të pavarur ligjor dhe procedural, rekomandohet pezullimi i çdo ndërhyrjeje të pakthyeshme në territor, përfshirë prishjet dhe transformimet strukturore në zonat me ndjeshmëri arkeologjike dhe historike.



Ky pezullim synon të shmangi krijimin e dëmeve të pakthyeshme në trashëgiminë kulturore dhe të garantojë që çdo vendimarrje e mëtejshme të bazohet në një vlerësim të plotë teknik, ligjor dhe shkencor.

7. Gatishmëria për bashkëpunim

Zhvillimi urban dhe turistik i qytetit mbetet i rëndësishëm për interesin publik dhe ekonominë lokale, por kërkon procese transparente, gjithëpërfshirëse dhe të mbështetura në ekspertizë profesionale. Qendra Amfora shpreh gatishmërinë për të mbështetur dialogun e mëtejshëm teknik dhe publik, duke garantuar një proces informues, të balancuar dhe të dokumentuar, në funksion të interesit publik dhe të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.


NËNSHKRUES:

MSc. Geri Emiri, drejtor ekzekutiv, Qendra Amfora



EKSPERTË, PANELISTË NË FORUM:

Ark. Urb. MSc. Entela Koja (Spahiyogli)



Doktor shkencash në Urbanistikë, Artan Kacani

